VENDIM
Nr. 481, datë 10.7.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (MARRËSI), BASHKISË TIRANË (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT), DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR SHËRBIMET E EKSPERTIT NDAJ AGJENCISË ZBATUESE TË PROJEKTIT, NË KUADËR TË PROJEKTIT TË TRANSPORTIT TË GJELBËR NË TIRANË, QË FINANCOHEN NGA NJË FOND I VEÇANTË I SIGURUAR NGA QEVERIA FEDERALE GJERMANE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Bashkisë Tiranë (Agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për shërbimet e ekspertit ndaj agjencisë zbatuese të projektit, në kuadër të projektit të transportit të gjelbër në Tiranë, që financohen nga një fond i veçantë i siguruar nga qeveria Federale Gjermane, me një grant në shumën 1 670 000 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE FINANCIMI
Datë 3.6.2019
NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN ("KfW") DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË ("MARRËSI") DHE BASHKISË TIRANË ("AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT")
për
EUR 1,670,000.00

Për Shërbimet e Ekspertit ndaj Agjencisë Zbatuese të Projektit në kuadrin e Projektit të Transportit të Gjelbër në Tiranë, që financohet nga një fond i veçantë (Studien und Beratungsfonds) nr. 20239 siguruar nga Qeveria Federale Gjermane.

Përmbajtja

Neni 1	Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar
Neni 2	Transferimi i kontributit financiar tek Agjencia Zbatuese e Projektit
Neni 3	Disbursimi
Neni 4	Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja
Neni 5	Kostot dhe detyrimet publike
Neni 6	Deklarimet kontraktuale dhe kompetencat e përfaqësimit
Neni 7	Shërbimet e Ekspertit
Neni 8	Shërbimet e Konsulentit

Neni 9 Publikimi dhe transferimi i informacionit që ka lidhje me shërbimet e Ekspertit
Neni 10 Dispozita të ndryshme
Aneksi 1 (a) Angazhime të pajtueshmërisë të Marrësit
Aneksi 1 (b) Angazhime të pajtueshmërisë të Agjencisë Zbatuese të Projektit

Në bazë të autorizimit të dhënë nga Qeveria Federale Gjermane datë 9 korrik 2018 dhe kërkesës së Agjencisë Zbatuese të Projektit, me mbështetjen e Marrësit, Marrësi, Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW lidhin Marrëveshjen e Financimit si vijon:

Neni 1
Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW do t'i japë Marrësit një kontribut financiar deri në

EUR 1,670,000.00
("Kontributi Financiar").

Ky kontribut financiar nuk është i shlyeshëm, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi do të vendosë kontributin e plotë financiar në dispozicion të Agjencisë Zbatuese të Projektit në përputhje me kushtet e parashtruara në nenin 2. Agjencia Zbatuese e Projektit do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për financimin e shërbimeve të ekspertit si vijon:

Përgatitja e një studimi fizibiliteti për një sistem transporti publik në Tiranë, Shqipëri ("Shërbimet e Ekspertit").

1.3 Agjencia Zbatuese e Projektit do të japë kontributetet e saj plotësuese në mënyrë të plotë dhe në kohën e duhur. Agjencia Zbatuese e Projektit do t'i japë KfW-së, në vijim të kërkesës së saj, evidencë që vërteton masat e marra në këtë drejtim.

1.4 Tatimet dhe taksat e tjera publike të cilat i lindin Marrësit ose Agjencisë Zbatuese të Projektit, si dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga Kontributi Financiar.

Neni 2
Transferimi i kontributit financiar tek Agjencia Zbatuese e Projektit

2.1 Marrësi do të transferojë kontributin financiar tek Agjencia Zbatuese e Projektit si një grant i pakthyeshëm nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi financiar, Marrësi do t'i japë KfW-së një kopje ose një përkthim të certifikuar në gjuhën gjermane ose angleze të marrëveshjes së referuar në nenin 2.1.

2.3 Transferimi i kontributit financiar nuk do të përbëjë asnjë përgjegjësi të Agjencisë Zbatuese të Projektit kundrejt KfW-së, për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Disbursimi

3.1 Marrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit autorizon këtu KfW-në për të kryer parapagime, pagesa të përkohshme dhe përfundimtare nga kontributi financiar për Konsulentin (siç përcaktohet në nenin 7.1 a). Këto pagesa do të kryhen në përputhje me ecurinë e Shërbimeve të Ekspertëve mbi bazën e faturave origjinale të paraqitura tek KfW (kopje për Agjencinë Zbatuese të Projektit) dhe në përputhje me kontratat që duhet të lidhen ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe Konsulentit ("Kontrata e Konsulencës"). Ky autorizim nga Marrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit do të konsiderohet se është një kërkesë për disbursim

për të gjitha pagesat e përmendura më sipër. Marrësi që vepron nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit mund t'i kërkojë KfW-së, duke bërë një kërkesë me shkrim, të pezullojë pagesat nga kontributi financiar.

3.2 Për pagesat e kryera në një monedhë të ndryshme nga ajo e përcaktuar ("monedhë e huaj"), KfW-ja do të debitojë Marrësin me një shumë të tillë në euro, siç është shpenzuar nga KfW për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet rastësore.

3.3 KfW-ja nuk do të jetë përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga transferimi i institucioneve bankare në disbursimin ose dërgesat e çfarëdo pagese nga ana e KfW-së. Nëse shkaktohet ndonjë vonesë nga KfW-ja, përgjegjësia e saj do të kufizohet në pagesën e interesit të akumuluar.

3.4 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30.6.2021.

3.5 Kontrata e konsulencës do përfshijë një dispozitë që përcakton se çdo rimbursim, garanci ose pagesë e ngjashme që kërkohet dhe çdo pagesë siguracioni, do kryhet për llogari të Marrësit tek KfW, Frankfurt am Main, IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00, BIC: KFWIDEFF, dhe KfW-ja do kreditojë pagesa të tilla në llogarinë e Marrësit.

Neni 4
Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet përveç rasteve kur:

a) marrësi dështon në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur ato duhet të kryhen;

b) detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje janë shkelur;

c) Agjencia Zbatuese e Projektit nuk mund të vërtetojë se shumat e disbursuara janë përdorur të gjitha për qëllimin e paracaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) lindin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e shërbimeve të ekspertëve; ose

f) Kontrata e konsulencës është shkelur, ka përfunduar ose është pezulluar.

4.2 Nëse cilado nga situatat e specifikuara në nenin 4.1 b), c), ose d) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë do jetë të paktën 30 ditë, atëherë KfW-ja:

a) në rastet e specifikuara në nenin 4.1 b), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara; në rastin e nenit 4.1 d) mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave, pagesa e të cilave tek Marrësi ose lënia me Marrësin përbën shkelje të ligjit të zbatueshëm;

b) në rastet e specifikuara në nenin 4.1 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave për të cilat Agjencia Zbatuese e Projektit nuk mund të vërtetojë se janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Neni 5
Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që akumulohen jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje, si dhe koston e transfertave dhe koston e konvertimit të shkaktuar në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6
Deklarimet kontraktuale dhe kompetencat e përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ata persona të caktuar prej tij ose saj, kundrejt KfW-së dhe autorizohen nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë Marrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe ata persona që caktohen prej tij ose kundrejt për KfW-së dhe autorizohen nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj, do përfaqësojnë Agjencinë Zbatuese të Projektit në ekzekutimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Kompetencat e përfaqësimit nuk skadojnë derisa të jetë marrë prej KfW-së anulimi shprehimisht nga përfaqësuesit e autorizuar për atë kohë.

6.2 Çdo ndryshim apo shtesë dhe çdo njoftim apo deklaratë nga palët kontraktuese në këtë Marrëveshje duhet të bëhet me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë autorizohet të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm periudhën e vlefshmërisë (neni 3.4) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë do të konsiderohet e marrë sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese apo në ndonjë adrese tjetër të palës kontraktuese sipas njoftimit të bërë palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në	KfW Postfach 11 11 41 60046 Frankfurt am Main Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë) Faks: +49 69 7431-2944
Për Marrësin:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 3 Tiranë
Për Agjencinë Zbatuese të Projektit:	Bashkia e Tiranës Sheshi "Skënderbej", nr. 2, Kodi postar 1001, Tirana

6.3 Ndryshimet në këtë Marrëveshje që prekin vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Marrësit nuk do të kërkojnë miratimin e Agjencisë Zbatuese të Projektit.

Neni 7
Shërbimet e Ekspertëve

7.1 Agjencia Zbatuese e Projektit

a) do i caktojë Shërbimet e Ekspertit konsulentëve të pavarur të kualifikuar ("Konsulenti") me praktika të qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe në thelb, në përputhje me konceptin e projektit tëdakordësuar ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe KfW-së për Shërbime Ekspertësh;

b) në vijim të parapërzgjedhjes dhe tenderimit konkurrues ndërkombëtar publik, do t'i japë kontratën e konsulencës një Konsulenti të kualifikuar të pavarur. Procedura për Dhënien e kontratës së konsulencës do të zbatohet sipas "Udhëzimeve për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim" (versioni janar 2019 sikundër publikuar në faqen e KfW-së në datën e kësaj marrëveshje)[1].

[1] https://www.kfw-entwicklungsbank.de/PDF/Download-Center/PDF-Dokumente-Richtlinien/Vergaberichtlinien-2019-Englisch-Internet_2.pdf

Për këtë qëllim, KfW-së do t'i jepet në kohën e duhur drafti i Kontratës së Konsulencës, dokumentet për kualifikimet e ekspertëve të zgjedhur dhe i gjithë dokumentacioni tjetër i duhur, sipas kërkesës së KfW-së;

c) do ruajë, ose do marrë masa për ruajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e pësuara në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe që identifikojnë në mënyrë të qartë shërbimet e financuara nga Kontributi Financiar;

d) do i mundësojë përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrimet e përmendura dhe të gjithë dokumentacionin tjetër të përshtatshëm për zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

e) do i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për Shërbimet e Ekspertëve dhe për ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së;

f) do komentojë për raportet e Konsulentit ose do njoftojë miratimin e tij për përmbajtjen duke nënshkruar raportet dhe

g) do marrë vendimet e saj për të gjitha skicat, raportet, studimet dhe zëvendësimin e anëtarëve të stafit të Konsulentit në marrëveshje me KfW-në.

7.2 Marrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, do të sigurojë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe me kërkesë të KfW-së, do t'i japë KfW-së prova që vërtetojnë se kostot që nuk janë paguar nga ky kontribut financiar, janë të mbuluara;

7.3 Marrësi dhe Agjencia Zbatuese të Projektit, me pëlqimin e tyre, do informojnë menjëherë KfW-në për të gjitha rrethanat që parandalojnë ose rrezikojnë në mënyrë serioze zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve ose qëllimin e tyre.

7.4 Marrësi do asistojë Agjencinë Zbatuese të Projektit në përputhje me praktikat e mira inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe në realizimin e detyrimeve të Agjencisë Zbatuese të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në mënyrë të veçantë, do t'i mundësojë Agjencisë Zbatuese të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve, nëse ka, ose do mbështesë Agjencinë Zbatuese të Projektit me marrjen e lejeve të tilla.

7.5 Menjëherë pas përfundimit të Shërbimeve të porositura të Ekspertëve, KfW-ja do të pajiset me një numër kopjesh të të gjitha skicave, raporteve, studimeve të përgatitura nga Konsulenti, sipas kërkesës së KfW-së. KfW-ja mund të ketë bërë vlerësimin e studimeve të përmendura.

7.6 Nga financimi i Shërbimeve të Ekspertëve, as Marrësit, as Agjencisë Zbatuese të Projektit nuk mund t'i lindë asnjë e drejtë për financimin nga KfW të projektit të përgatitur nga Shërbimet e Ekspertëve. Marrësi dhe Agjencia Zbatuese e Projektit, megjithatë, i japin Republikës Federale të Gjermanisë një mundësi për të financuar projektin sipas Bashkëpunimit Financiar.

Neni 8
Shërbimet e Konsulentit

8.1 Detyrat e Konsulentit do të përfshijnë sa vijojnë:

- Konsulenti do të grumbullojë dhe analizojë të gjitha studimet dhe dokumentacionin e disponueshëm në lidhje me Projektin, do të kryejë një vlerësim të plotë të situatës ekzistuese të korridoreve që duhen përcaktuar, duke përfshirë studimet paraprake inxhinierike dhe gjeoteknike dhe përpunimin e diskutimin e një koncepti zhvillimi për një Sistem Transporti Publik bazuar në BRT (Tranzit Autobus i Shpejtë), në Tiranë.

- Konsulenti do të vlerësojë fizibilitetin e një sistemi Tranzit Autobus i Shpejtë për sa i takon çështjeve teknike, financiare, ekonomike, mjedisore dhe sociale, ligjore dhe institucionale dhe operacionale në korridoret që do të përcaktohen;

- Konsulenti do zhvillojë projekte të kërkesës së transportit përgjatë korridoreve që do përcaktohen, në kontekstin e rrjetit të tyre, për hapësira kohore të ndryshme, duke modeluar trafikun bazuar në të dhënat e studimeve të transporteve dhe trendin rritës në zonën e influencës

së projektit. Projektet do përfshijnë ndikimet e projekteve të siguruara dhe potenciale të transportit dhe zhvillimit.

8.2 KfW-ja do zotërojë të drejtën e pakufizuar për të përdorur dhe shfrytëzuar rezultatet e Shërbimeve të Ekspertëve dhe të gjitha dokumentet që lidhen me to, të financuara nga ky Kontribut Financiar gjatë gjithë kohës dhe në të gjitha vendndodhjet sipas zgjedhjes së saj.

Neni 9

Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Shërbimet e Ekspertit

9.1 Në përputhje me parimet e pranuara ndërkombëtarisht të transparencës maksimale dhe efikasitetit në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacion të përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) rreth Shërbimeve të Ekspertëve dhe se si financohen ato gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa marrëveshja/et në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve - është\janë duke u zbatuar dhe në fazën pas kontraktimit (këtu e tutje referuar si "Periudha e Plotë").

Informacioni publikohet periodikisht në faqen e KfW-së për fushën e saj të biznesit "Banka e Zhvillimit KfW" ("KfW Development Bank") (http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 9.3 më poshtë) për Shërbimet e Ekspertëve dhe si ata financohen nuk përfshin dokumentacionin kontraktual ose ndonjë informacion sensitiv financiar apo informacion sensitiv biznesi për palët e përfshira në Shërbimet e Ekspertëve ose në financimin e tij, të tilla si:

a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;

b) strategji biznesi;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme korporative;

d) të dhëna personale të personave fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

9.2 KfW-ja ndan informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën sesi ato financohen gjatë të gjithë periudhës me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh gjerman për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internacionale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizatat ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarë të tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj.

9.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacion të përzgjedhur në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe se si ato financohen gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat botojnë paragrafët që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllime të Iniciativës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare (http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI) për qëllime të informacionit të tregut (http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO);

c) OECD për qëllimin e raportimit të rrjedhës financiare në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit (http://stats.oecd.org/);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllime të vlerësimit të zhvillimit të përgjithshëm të bashkëpunimit Gjerman për të garantuar transparencën dhe eficiencën (http://www.deval.org/de/).

9.4 Gjithashtu, KfW-ja rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe sesi ato financohen gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Marrësit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KFW-së për transferimin e këtij informacioni. interesat e ligjshme të Marrësit në veçanti përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 9.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve, ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

Neni 10
Dispozita të Ndryshme

10.1 Marrësi zotohet të jetë në përputhje gjatë gjithë kohës me detyrimet e parashtruara në Aneksin 1 a (Angazhime të Pajtueshmërisë për Marrësin). Agjencia Zbatuese e Projektit ndërmerr që të jetë në përputhje gjatë gjithë kohës me detyrimet e parashtruara në Aneksin 1 b (Angazhime të Pajtueshmërisë për Agjencinë Zbatuese të Projektit).

10.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rezultojë prej kësaj do të plotësohet me një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

10.3 Marrësi nuk mund të kalojë, transferojë, rëndojë me peng apo hipotekë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

10.4 Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main. Marrëdhëniet ligjore të vendosura ndërmjet KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë Zbatuese të Projektit do të përfundojnë gjashtë vjet pas disbursimit të fundit.

10.5 Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi pasi KfW të ketë marrë njoftim me shkrim nga Marrësi se të gjitha procedurat e brendshme ligjore për t'u përmbushur nga Marrësi janë realizuar.

Përgatitur në 3 (tri) origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, më 3.6.2019	Tiranë më 3.6.2019
KfW	Republika e Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë Më 30.5.2019 Bashkia Tiranë

Anekset
Aneksi 1a: Angazhime të Pajtueshmërisë për Marrësin
Aneksi 1b: Angazhime të Pajtueshmërisë për Agjencinë Zbatuese të Projektit

ANEKSI 1A
ANGAZHIME TË PAJTUESHMËRISË SË MARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

Praktika shtrënguese: dëmtimi ose cenimi, ose kërcënimi për të dëmtuar ose cënuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person ose pasuri të personit me qëllim që të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme veprimet e një personi.

Praktika e fshehtë: një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e cila hartohet për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

Praktika korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çdo natyre, për ose nga cilido person, me qëllim ndikimin e veprimeve të çdo personi ose shkaktimin e përmbajtjes së çfarëdo personi nga çfarëdo veprimi.

Praktika mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin, që me vetëdije ose pakujdesi mashtron ose përpiqet të mashtrojë një person për të marrë një përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Praktika Penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e dëshmive materiale në mënyrë të qëllimshme për hetimin ose kryerjen e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese ose Praktikë të Fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi ose frikësimi i cilitdo personi për ta penguar atë, të zbulojë njohuritë e tij për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin ose ndjekjen e hetimit; ose ii) çdo veprim që ka për qëllim të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese ose Praktikë të fshehtë.

Person: çdo person fizik, ent ligjor, partneritet ose shoqëri e pa themeluar.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (si termat të tillë të përcaktuara këtu), e cila: i) është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër në fuqi; dhe ii) e cila ka, ose potencialisht mund të ketë, një efekt ligjor material ose reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së ose zbatimit të saj.

Sanksionet: ligjet për sanksionet ekonomike, financiare ose tregtare, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga cilido organ sanksionues.

Organi sanksionues: cilido prej Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Republikës Federale të Gjermanisë.

Lista e sanksioneve: çdo listë me persona, grupe ose ente të caktuara specifikisht, të cilët i nënshtrohen Sanksioneve, siç është lëshuar nga çdo organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Marrësi

a) do vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së, sipas kërkesës, të gjitha informacionet që kanë lidhje me "njihni klientin tuaj" ose informacione të ngjashme për Marrësin, ashtu siç mund ta kërkojë KfW-ja;

b) nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, t'i sigurojë menjëherë KfW-së sipas kërkesës, të gjitha informacionet dhe dokumentet e Marrësit dhe të palëve të tij (nën)kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të për Shërbimet e Ekspertëve, të cilat janë të nevojshme për KfW-në, të përmbushë detyrimet e saj në mënyrë që të parandalojë çdo Praktikë të Sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Marrësin, i cili është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, të informojë KfW-në, menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo vihet në dijeni ose dyshon për çfarëdo Praktike të Sanksionueshme, vepër e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit e cila lidhet me Shërbimet e Ekspertëve;

d) nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, t'i sigurojë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për Shërbimet e Ekspertëve dhe progresin e tyre të mëtejshëm, siç mund ta kërkojë KfW-ja për qëllimet të këtij aneksi; dhe

e) nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, t'i mundësojë KfW-së dhe agjentëve të saj në çfarëdo lloj kohe, të inspektojë të gjithë dokumentacionin e Marrësit dhe të palëve të tij (nën)kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të, siç është e përshtatshme për zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve për qëllime të këtij aneksi.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të Marrësit, Marrësi përfaqëson se asnjë nga Personat të cilët veprojnë në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve në emër të Marrësit nuk ka kryer ose nuk është i angazhuar në asnjë praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia të parashtruara në këtë nen kryhen për herë të parë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje. Do konsiderohet të përsëritet mbi çdo tërheqje të kontributit financiar duke iu referuar rrethanave që dominojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Marrësi merr përsipër, sapo Marrësi ose KfW-ja vihen në dijeni ose dyshojnë për çdo praktikë të sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave ose financim të terrorizmit, për të bashkëpunuar plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, në përcaktimin nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në mënyrë të veçantë, Marrësi do të përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme ndaj çdo njoftimi nga KfW-ja dhe do të sigurojë mbështetje dokumentare për një përgjigje të tillë me kërkesën e KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk do kryejë asnjë transaksion, as nuk do angazhohet në asnjë aktivitet tjetër në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve të cilat do përbënin një shkelje të Sanksioneve.

ANEKSI 1B
ANGAZHIME TË PAJTUESHMËRISË SË AGJENCISË ZBATUESE TË PROJEKTIT

1. PËRKUFIZIME

Praktika shtrënguese: dëmtimi ose cënimi, ose kërcënimi për të dëmtuar ose cënuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person ose pasuri të personit me qëllim që të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme veprimet e një personi.

Praktika e fshehtë: një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e hartuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

Praktika korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çdo natyre, për ose nga cilido person, me qëllim ndikimin e veprimeve të çdo personi ose shkaktimin e përmbajtjes së cilitdo personi nga çfarëdo veprimi.

Kategori të caktuara shkeljesh: kategoritë e mëposhtme të shkeljeve të përcaktuara sipas rekomandimeve të FATF dhe shënimet interpretuese përkatëse: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe mashtrimi/shantazhi; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimin e paligjshëm të barnave narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimin e paligjshëm të armëve; trafikimin e paligjshëm të mallrave të vjedhura dhe të mallrave të tjera; korrupsioni dhe ryshfeti; mashtrimi; falsifikimi i monedhës; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi, mbajtja e paligjshme dhe marrja peng; grabitja ose vjedhja; kontrabanda (duke përfshirë lidhjen me doganat dhe akcizat dhe taksat); krimet tatimore (lidhur me taksat direkte dhe indirekte); zhvatja; falsifikimi; pirateria; tregtimi i paligjshëm në bursë dhe manipulimi i tregut.

Rekomandimet e FATF-së: rekomandime të tilla siç përcaktohen herë pas here nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF). FATF është organi ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është

zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Praktika mashtruese: çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose përpiqet të mashtrojë një person për të marrë një përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Origjina e paligjshme: origjina e fondeve të përfituara nëpërmjet

a) çdo shkeljeje të listuar në kategoritë e përcaktuara të shkeljeve;

b) çdo praktikë korruptive;

c) çdo praktikë mashtruese; ose

d) pastrim parash.

Praktika Penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e dëshmive materiale në mënyrë të qëllimshme për hetimin ose kryerjen e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese ose Praktikë të Fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi ose frikësimi i cilitdo personi për ta penguar atë të zbulojë njohuritë e tij për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin ose ndjekjen e hetimit; ose ii) çdo veprim që ka për qëllim të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese ose Praktikë të fshehtë.

Person: çdo person fizik, ent ligjor, partneritet ose shoqëri e pa themeluar.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (siç terma të tillë përcaktohen këtu), e cila: i) është e paligjshme sipas ligjit gjerman në fuqi ose ligji tjetër në fuqi; dhe ii) e cila ka, ose potencialisht mund të ketë, një efekt ligjor material ose reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe KfW-së ose zbatimit të saj.

Sanksionet: ligjet për sanksionet ekonomike, financiare ose tregtare , rregulloret, embargot ose masat shtrënguese të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga cilido organ sanksionues.

Organi sanksionues: cilido prej Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Republikës Federale të Gjermanisë.

Lista e sanksioneve: çdo listë me persona, grupe ose ente të caktuara specifikisht, të cilët i nënshtrohen sanksioneve, siç është lëshuar nga çdo organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Agjencia Zbatuese e Projektit

a) do vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së, sipas kërkesës, të gjitha informacionet që kanë lidhje me "njihni klientin tuaj" ose informacione të ngjashme për Agjencinë Zbatuese të Projektit, ashtu siç mund ta kërkojë KfW-ja;

b) t'i sigurojë menjëherë KfW-së sipas kërkesës, të gjitha informacionet dhe dokumentet e Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe të palëve të saj (nën)kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të, të cilat janë të nevojshme për KfW-në të përmbushë detyrimet e saj në mënyrë që të parandalojë çdo praktikë të sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Agjencinë Zbatuese të Projektit, i cili është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) do informojë KfW-në, menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo të vihet në dijeni ose të dyshojë për ç'do praktike të sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave dhe/ose financimi të terrorizmit nga Agjencia Zbatuese e Projektit, cilido anëtar i organeve menaxhuese ose organeve të tjera drejtuese ose cilido prej aksionarëve të saj;

d) do i sigurojë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për Shërbimet e Ekspertëve dhe progresin e tyre të mëtejshëm, ashtu siç mund ta kërkojë KfW-ja për qëllime të këtij aneksi;

e) do i mundësojë KfW-së dhe agjentëve të saj në çdo kohë të inspektojnë të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me Shërbimet e Ekspertëve të Agjencisë Zbatuese të Projektit

dhe të palëve të saj (nën)kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të, si dhe të vizitojnë Shërbimet e Ekspertëve dhe të gjitha instalimet që lidhen me to për qëllimet e këtij aneksi;

f) do informojë KfW-në, menjëherë dhe me pëlqimin e saj, për çdo ngjarje që rezulton në cilindo prej sa vijon: Agjencia Zbatuese e Projektit, çfarëdo anëtar i organeve menaxhuese ose organe të tjera drejtuese ose cilido prej aksionarëve të saj, që është ose bëhet një shtetas i caktuar në mënyrë të posaçme, person i bllokuar ose ent që ruhet në çfarëdo liste sanksionesh.

3. PËRFAQËSIME DHE GARANCI

3.1 Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë Zbatuese të Projektit, Agjencia Zbatuese e Projektit përfaqëson dhe garanton se sa vijon është e vërtetë dhe korrekte:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia Zbatuese e Projektit vepron në emër të saj dhe për llogari të saj.

b) Sipas njohurive të saj më të mira dhe vetëm në lidhje me aksionarët e njohur për Agjencinë Zbatuese të Projektit, në vijim të rregullave që zbatohen për tregun e bursës, as kapitali i Agjencisë Zbatuese të Projektit, as fondet e investuara në Shërbimet e Ekspertëve nuk janë me origjinë të paligjshme.

c) Asnjë nga Agjencia Zbatuese të Projektit, filialet e saj, degët e saj apo çdo personi tjetër në emër të saj ose të tyre nuk ka kryer ose nuk angazhohet në asnjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

d) Agjencia Zbatuese e Projektit nuk ka lidhur: i) asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas të caktuar në mënyrë të posaçme, persona të bllokuar ose ent që ruhet në çdo listë sanksionesh; ose ii) të angazhuar në çdo lloj aktiviteti tjetër që do përbënte një shkelje të sanksioneve.

3.2 Përfaqësimet dhe garancitë e parashtruara në këtë nen bëhen për herë të parë me anë të ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen se do të përsëriten me çdo tërheqje të Kontributit Financiar duke iu referuar rrethanave që dominojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Agjencia Zbatuese e Projektit merr përsipër

a) të jetë në përputhje të plotë me standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me rekomandimet e FATF dhe të zbatojë, ruajë dhe nëse është e nevojshme, të përmirësojë standardet dhe udhëzimet e saj të brendshme (duke përfshirë pa kufizim në lidhje me klientin, verifikimin paraprak) të përshtatshëm për të shmangur çdo praktike të sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia Zbatuese e Projektit ose KfW-ja vihen në dijeni ose dyshojnë për çdo Praktikë të Sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, për të bashkëpunuar plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, në përcaktimin nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në mënyrë të veçantë, Agjencia Zbatuese e Projektit do përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme ndaj çdo njoftimi nga KfW dhe të japë mbështetje dokumentuese për një përgjigje të tillë me kërkesën e KfW-së.

5. SIPËRMARRJE NEGATIVE

Agjencia Zbatuese e Projektit merr përsipër:

a) të sigurojë se kapitali i saj dhe fondet e tjera të cilat ajo investon nuk do jenë me origjinë të paligjshme;

b) të sigurojë se biznesi i saj nuk do çojë në asnjë praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe

c) të mos lidhë apo vazhdojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas të caktuar në mënyrë të posaçme, persona të bllokuar ose ent që ruhet në çdo listë sanksionesh dhe nuk do angazhohet në asnjë lloj aktiviteti tjetër që do përbënte një shkelje të sanksioneve.